



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:032553

Datë: 23.02.2024

Numri i dokumentit: 05364286

C.nr.444/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve B.H., A.Ç., M.K., N.V. dhe S.D.H. nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. V.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i pagave jubilarë, vlera e kontestit 1,491.75 euro, jashtë seance, me datë 22.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve B.H., A.Ç., M.K., dhe N.V. nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit:

- B.H. nga Prizreni, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, t`ia paguaj shumën prej 229.50 euro apo 50 % të pagës bazë (vlera e pagës bazë 459.00 euro).
 - A.Ç. nga Prizreni, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune, t`ia paguaj shumën prej 344.25 euro apo 75 % të pagës bazë (vlera e pagës bazë 459.00 euro).
 - M.K. nga Prizreni, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, t`ia paguaj shumën prej 229.50 euro apo 50 % të pagës bazë (vlera e pagës bazë 459.00 euro).
 - N.V. nga Prizreni, në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune, t`ia paguaj shumën prej 459.00 euro apo të një page bazë (vlera e pagës bazë 459.00 euro).
- të gjitha këto shuma me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 06.02.2023, e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses S.D.H. nga Prizreni, me të cilën kanë kërkuar që të *“Detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që në emër të shpërblimit jubilar për 15 vite përvojë pune, t`ua paguaj shumën prej 50 % të pagës bazë në shumën prej 229.50 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, të*

gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm” e pabazuar.

IV. DETYROHET e paditura që paditësve B.H., A.Ç., M.K., dhe N.V. t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 290.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit B.H., A.Ç., M.K., N.V. dhe S.D.H. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate, me datë 06.02.2023, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i pagës jubilarë, vlera e kontestit 1,491.75 euro.

Sipas të cekurave në padi, paditësja B.H. ka mbi 12 vite përvojë pune, paditësja A.Ç. ka mbi 22 vite përvojë pune, paditësja M.K. ka mbi 12 vite përvojë pune, paditësi N.V. ka mbi 31 vite përvojë pune dhe paditësja S.D.H. ka mbi 15 vite përvojë pune, rroga bazë për këta mësimdhënës është 459.00 euro. Meqenëse e paditura nuk e ka përmbushur vullnetarisht kërkesën e paditësve për kompensimin e pagave jubilarë, gjykatës i kanë propozuar që të merr vendim dhe padinë dhe kërkesëpadinë e paditëseve ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve lidhur me kompensimin pagave jubilarë. E njëjta ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë, Shkencë, Teknologjisë dhe Inovacionit nr. 01B/488, të datës 21.11.2022, për Shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit, të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar. Po ashtu ka theksuar se përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësit nuk kanë ofruar ndonjë provë që janë anëtarë të sindikatës. Sipas saj, të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditëseve është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Në fund ka kërkuar nga gjykata, që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëseve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, përmes vërtetimit me numër 166, të datës 11.01.2023 të lëshuar nga drejtori i gjimnazit “Gjon Buzuku” në Prizren, ka vërtetuar faktin se paditësja B.H. është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta i ka 12 vite 4 muaj e 11 ditë përvojë pune.

Gjykata, përmes vërtetimit me numër 174, të datës 12.01.2023 të lëshuar nga drejtori i gjimnazit “Gjon Buzuku” në Prizren, ka vërtetuar faktin se paditësja A.Ç. është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta i ka 22 vite 10 muaj e 26 ditë përvojë pune.

Gjykata, përmes vërtetimit me numër 163, të datës 10.01.2023 të lëshuar nga drejtori i gjimnazit “Gjon Buzuku” në Prizren, ka vërtetuar faktin se paditësja M.K. është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta i ka 12 vite 4 muaj e 10 ditë përvojë pune.

Gjykata, përmes vërtetimit me numër 169, të datës 12.01.2023 të lëshuar nga drejtori i gjimnazit “Gjon Buzuku” në Prizren, ka vërtetuar faktin se paditësja N.V. është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe i njëjti i ka 31 vite përvojë pune.

Gjykata, përmes vërtetimit me numër 192, të datës 18.01.2023 të lëshuar nga drejtori i gjimnazit “Gjon Buzuku” në Prizren, ka vërtetuar faktin se paditësja S.D. është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta i ka 9 vite 4 muaj e 18 ditë përvojë pune.

Vërtetimet dhe vendimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj meqë vërtetimet e lartë cekura janë të lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, si të tilla janë të pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, ashtu që provave të lartcekura gjykata ia fali besimin, si provë me të cilat vërtetohet fakti lidhur me përvojën e punës për paditësit.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017. Me nenin 35 par.8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër të njësisë 01B, numër të prot.105, të datës 22.01.2021, është përcaktuar e drejta e punëtorëve (antarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit: dhe atë “*për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë; për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë; për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë; për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë*” .

Gjykata, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila përcakton se “*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.*”, pasi që vlerësoi se e paditura ka

pasur për detyrim që paditëses B.H. nga Prizreni, si punëtore e arsimit-mësimdhënëse, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, t'ia paguaj kompensimin në vlerë të 50 % të një pagë bazë shumë prej 229.50 euro (vlera e pagës bazë 459.00 euro), duke u bazuar në KKAK-së të datës 18.04.2017, bazuar në vërtetimin me numër 166 të datës 11.01.2023, i ka arritur 12 vite e 4 muaj e 11 ditë të përvojës së punës; paditëses A.Ç. nga Prizreni, si punëtore e arsimit-mësimdhënëse, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune, t'ia paguaj kompensimin në vlerë të 75 % të një pagë bazë shumë prej 344.25 euro (vlera e pagës bazë 459.00 euro), duke u bazuar në KKAK-së të datës 18.04.2017, bazuar në vërtetimin me numër 174 të datës 12.01.2023, i ka arritur 22 vite e 10 muaj e 26 ditë të përvojës së punës; paditëses M.K. nga Prizreni, si punëtore e arsimit-mësimdhënëse, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, t'ia paguaj kompensimin në vlerë të 50 % dhe të një pagë bazë shumë prej 229.50 euro (vlera e pagës bazë 459.00 euro), duke u bazuar në KKAK-së të datës 18.04.2017, bazuar në vërtetimin me numër 163 të datës 10.01.2023, i ka arritur 12 vite e 4 muaj e 10 ditë të përvojës së punës; paditësit N.V. nga Prizreni, si punëtor i arsimit-mësimdhënës, në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune, t'ia paguaj kompensimin në vlerë të një pagë bazë shumë prej 459.00 euro (vlera e pagës bazë 459.00 euro), duke u bazuar në KKAK-së të datës 18.04.2017, bazuar në vërtetimin me numër 169 të datës 12.01.2023, i ka arritur 31 vite të përvojës së punës.

Gjykata, vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitën ligjore 399 paragraf 1 të LPK-së, e cila përcakton se *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, pas vlerësimit të të gjitha provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara, ku rezultoi se kërkesëpadia e paditëses S.D.H. të refuzohet si e pabazuar.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e, si dhe dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), me nr. të njësisë 01B, nr. prot.105, të datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Nga vërtetimi mbi përvojën e punës të lëshuar nga e paditura me datë 18.01.2023, me nr. 192, vërtetohet fakti se paditësja S.D.H. me datë 18.01.2023 ka përvojë pune prej 9 viteve, 4 muaj dhe 18 ditë, në këtë drejtim paditësja të drejtën për të kërkuar shpërblimin jubilar për 10 vite të përvojës së punës do ta arrin në vitin 2024, në kohën kur nuk është më në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, e cila është aplikuar në periudhën kohore nga data 22.01.2021 e deri me datën 21.11.2022, andaj për këtë arsye kërkesëpadia e paditëses është dashur të refuzohet.

Gjykata vlerësoi se paga bazë, të cilëve duhet t'u kompensohet paditësve në emër të shpërblimit jubilar është në lartësi prej 459.00 euro, kjo duke u bazuar në faktin se paga bazë për mësimdhënësit në Republikën e Kosovës, është në lartësi prej 459.00 euro.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, lidhur me pjesën aprovuese sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në

përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (06.02.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 260 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 290.00 euro.

Andaj, gjykata bazuar në arsyet dhe faktet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143, lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.444/2023, datë 22.02.2024

Gj y q t a r j a

Edije Sezairi

KËSHILË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.